



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 46, datë 09.07.2026

**PËR EMËRTIMIN E GJIMNAZIT MANËZ, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE
MANËZ, NË BASHKINË Durrës**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.114/2015, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Gjimnazit Manëz t’i vendoset emërtimi: Gjimnazi “Enver Farruku” Manëz.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 10.07.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 537₁₂ prot.

Durrës, më 15 . 07 .2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.46 datë 09.07.2026 “Për emërtimin e gjimnazit Manëz, në njësinë administrative Manëz, ne Bashkinë Durrës.”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ADRIAN GURRA